



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 53 regjistër (JR)
Datë 09.11.2023

Nr. 87 i vendimit
Datë 25.11.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Rezarta Schuetz	Kryesuese
Albana Shtylla	Relatore
Mimoza Tasi	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 25.11.2025, ditën e martë, në orën 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Anisa Sejдини, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit (JR) nr. 53/2023, datë 09.11.2023, që i përket:

ANKUESE: Komisionerja Publike, Irena Nino.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 702, datë 27.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Agron Bushati

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, nenet C, pika 2 dhe F të Aneksit të Kushtetutës; neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), analizoi shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisionerja Publike Irena Nino (në vijim “Komisioneri Publik”), dëgjoji

përfaqësuesin e autorizuar të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, z. Klodjan Braho (në vijim “Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme”), i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 702, datë 27.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Agron Bushati, si dhe avokaten e tij Romina Zano, të cilët përfundimisht kërkuan lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Albana Shtylla, si dhe pasi e bisedoi atë në prani të vëzhguesit ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Agron Bushati [në vijim “subjekti i rivlerësimit”] ka ushtruar detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër, dhe në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*.
2. Komisioni, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara për subjektin e rivlerësimit nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtorja e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”).

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport¹ të hollësishëm dhe të arsyetuar, duke konstatuar se: *a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin; b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; d) nuk ka kryer deklarim të rremë; e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2 DSIK-ja, pasi kreu kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, dërgoi pranë Komisionit, raportin² mbi kontrollin e figurës bazuar në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, në të cilin ka arritur në konkluzionin për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit Agron Bushati.

2.3 KLP-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale nëpërmjet rishikimit të dokumenteve ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, duke dërguar pranë Komisionit një raport³ të hollësishëm, bazuar në nenin 43 të ligjit nr. 84/2016.

3. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara nga organet ndihmëse, kreu procesin e rivlerësimit

¹ Akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Agron Bushati, është përcjellë në Komision nga ILDKPKI-ja me shkresën nr. {***} prot., datë 10.04.2018.

² Raporti nr. {***} prot., datë 01.11.2017, i deklasifikuar plotësisht me vendim të KDZh-së nr. {***}, datë 14.10.2022.

³ Raport për vlerësimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit Agron Bushati nr. {***} prot., datë 22.06.2023.

kalimtar për subjektin e rivlerësimit, bazuar në tri kriteret e vlerësimit -- vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

4. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit [në vijim “Komisioni”], me vendimin nr. 702, datë 27.09.2023, vendosi: *“1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Agron Bushati, prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër. 2. Në zbatim të pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, të referojë pranë organit kompetent (ILD) për vlerësim denoncimin e ardhur pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në datën 26.09.2023, bazuar në nenin 103/e të ligjit nr. 96/2016. [...]”*.
5. Ky vendim është marrë bazuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, shkronja “a”, si dhe në nenin 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi ka arritur në konkluzionet për secilin prej kriterëve të rivlerësimit se subjekti i rivlerësimit arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë dhe në kontrollin e figurës, si dhe ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

III. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik

6. Kundër këtij vendimi ka ushtruar ankim Komisioneri Publik, duke pretenduar se ekzistojnë rrethana të tilla ligjore e fakti, për të cilat çmohet se ai duhet t’i paraqitet për shqyrtim, nëpërmjet ankimit, juridiksionit kontrollues dhe rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit [në vijim “Kolegji”]. Komisioneri Publik, referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, ndan gjykim të kundërt me Komisionin, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm të vlerësimit të kriterit të aftësive profesionale, dhe nga vlerësimi tërësor i çështjes, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, për subjektin e rivlerësimit duhet të gjejë zbatim neni 61, pikat 4 dhe 5 të këtij ligji. Në konkluzion, Komisioneri Publik kërkoi që Kolegji të marrë në shqyrtim shkaqet e ankimit dhe në përfundim të gjyqimit, në zbatim të nenit 66 të ligjit nr. 84/2016, të vendosë ndryshimin e vendimit nr. 702, datë 27.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Agron Bushati.
7. Komisioneri Publik ka parashtruar, në ankim, disa pretendime në drejtim të vlerësimit të aftësive profesionale, të cilat paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:
 - 7.1 *Në lidhje me procedimin penal nr. {***} të vitit 2003*, shkelja e konstatuar në mosveprimin e subjektit të rivlerësimit është e tillë që kualifikohet në ato që cenojnë besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
 - 7.2 *Në lidhje me denoncimin e shtetasit K. B.*, shkelja e konstatuar në mosveprimin e subjektit të rivlerësimit është e tillë që kualifikohet në ato që cenojnë besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
 - 7.3 *Në lidhje me denoncimin me postë elektronike të datës 26.09.2023*, sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me çfarë pritet nga një prokuror, i cili duhet të kujdeset që veprimet e tij të jenë në përputhje me detyrimet e marra përsipër, duke u gjendur në situatën e kualifikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016;

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

8. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit, i parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, duke pasur për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit mbi bazën e ankimit të Komisionerit Publik dhe duke mos qenë në kushtet e parashikuara nga neni E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit.

b) Legjitimimi i ankuesit

9. Komisioneri Publik legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit nr. 702, datë 27.09.2023, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

10. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, çështja objekt gjykimi u mor në shqyrtim nga Kolegji në seanca gjyqësore publike, në prani të palëve, të cilat u zhvilluan në datat 05.11.2025, 13.11.2025 dhe 25.11.2025. Trupi gjykues i Kolegjit, për shkak të mbarimit të mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, në zbatim të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës⁴ dhe nenit 199, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Civile, vendosi kalimin procedural nga Komisioneri Publik tek Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, përfaqësuar në Kolegji për këtë çështje nga prokurori i autorizuar Klodjan Braho⁵.
11. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegji, në seancën gjyqësore publike të datës 05.11.2025, në vijim të kërkesës së subjektit të rivlerësimit për administrimin nga ana e Kolegjit, në cilësinë e provave të reja të akteve shkresore të depozituara së bashku me parashtrimet e tij, pasi dëgjoji edhe Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme lidhur me këtë kërkesë, në bazë të nenit F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 45 dhe 49, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues, me vendim të ndërmjetëm, vendoi të çelë hetimin gjyqësor, duke pranuar në cilësinë e provës një pjesë të akteve⁶ të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me parashtrimet e datës 31.10.2025. Gjithashtu, në

⁴ Referuar parashikimit të nenit 179/b, pika 8 e Kushtetutës me mbarimin e mandatit kushtetues të institucionit të Komisionerëve Publikë, kompetencat e tyre ushtrohen nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme.

⁵ Me autorizimin nr. {***} prot., datë 29.10.2025, të Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme.

⁶ Aktet e numëruara nga 1 deri në 6 në inventarin e akteve referuar dhe lexuar për procesverbalin e seancës gjyqësore nga avokatja Romina Zano: 1. e-mail i datës 29.10.2025 dërguar ILD-së; 2. kthim përgjigje e ILD-së e datës 29.10.2025, të cilës i bashkëlidhet shkresa përcjellëse nr. {***} prot., datë 29.10.2025, si dhe vendimi "Për arkivimin e shqyrtimit fillestar", me nr. {***} prot., datë 29.07.2024; 3. urdhër nr. {***}, datë 06.12.2018, i Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër; 4. informacion drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë, datë 12.02.2019, nga subjekti i rivlerësimit; 5. raporti vjetor i vitit 2018 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër; 6. foto nga aktivitetet e sportit Taekwondo.

vlerësim të akteve të sjella⁷ nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me denoncimin e shtetasit I. H.⁸, trupi gjykues vendosi të mosçelë hetimin gjyqësor lidhur me këtë denoncim nën dritën e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016. Në seancën gjyqësore publike të datës 13.11.2025, në konkluzionet përfundimtare, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, duke iu qëndruar shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, kërkoi nga Kolegji ndryshimin e vendimit nr. 702, datë 27.09.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Agron Bushati. Subjekti i rivlerësimit, në konkluzionet përfundimtare, i kërkoi Kolegjit lënien në fuqi të vendimit të sipërcituar të Komisionit.

12. Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues vlerësoi shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, qëndrimet e palëve përgjatë procesit gjyqësor, si dhe analizoi e vlerësoi të gjitha provat që gjendeshin në dosjen e hetimit administrativ të Komisionit, si dhe ato të cilat u morën gjatë procesit gjyqësor në Kolegj, dhe që iu nënshtruan debatit gjyqësor prej palëve, duke arsyetuar e konkluduar si vijon.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit në lidhje me shkaqet e ankimit

*Në lidhje me procedimin penal me nr. {***}, të vitit 2003*

13. Komisioni, në vendim⁹, ka arritur në konkluzionin se: [...] nga ana e subjektit rezulton se janë shfaqur mangësi në kriterin e aftësive organizative. Në lidhje me këto mangësi rezulton se ndaj subjektit është marrë një masë disiplinore dhe pas përfundimit të kësaj mase ai nuk ka vijuar më tej me kryerjen e të njëjtave veprime si në rastin e procedimeve të mësipërme. Në këto kushte, Komisioni vlerëson se ato janë korrigjuar nga subjekti përgjatë 14 viteve pune në vijim të tij, pasi nga 5 dosjet e përzgjedhura me short dhe nga 3 vendimet e depozituara prej tij nuk janë konstatuar zvarritje të procedimeve penale. Në përfundim, Komisioni, duke marrë në konsideratë faktin se subjekti ka marrë një dënim në lidhje me këto procedime, si dhe nuk ka vijuar më tej me zvarritjen

⁷ Certifikatë nr. {***}, e muajit maj 2012, në emër të Genti Bushati për ushtrimin e veprimtarisë së përmbaruesit gjyqësor privat; -- vërtetim për statusin aktiv, nr. {***}, datë 29.10.2025; -- kontratë huaje dhe hipoteke nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.11.2014; -- urdhër ekzekutimi nr. {***}, datë 05.10.2015, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; -- kontratë shërbimi nr. {***}, datë 03.11.2015; -- kërkesë me shkrim dore e datës 03.11.2015 për vënie në ekzekutim të kontratës së huasë nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 10.11.2014; -- lajmërim për ekzekutim vullnetar nr. {***} regj., datë 03.11.2015, me konfirmë postare; -- kërkesë nr. {***} regj., datë 06.01.2016, për caktim përfaqësuesi të debitorit; -- vendim nr. {***}, datë 10.03.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër; -- lajmërim nr. {***} regj., datë 16.03.2016, për ekzekutim vullnetar, me konfirmë postare; -- vendim nr. {***} regj., datë 29.03.2016, për kalim në ekzekutim të detyrueshëm, me konfirmë postare; -- urdhër nr. {***} regj., datë 29.03.2016, ripërsëritje të urdhër për vënien e sekuestros, me konfirmë postare; -- vendim nr. {***} regj., datë 22.06.2019, për shpalljen e shitjes në ankand të 3-të të pasurisë së paluajtshme, me konfirmë postar; -- ofertë për marrjen pjesë në ankand, datë 22.07.2019; -- procesverbal nr. {***} regj., datë 22.07.2019, mbi zhvillimin e ankandit të 3-të; -- urdhër nr. {***} regj., datë 06.01.2020, për kalim në pronësi në favor të blerësit në ankand; -- kërkesë me shkrim dore e datës 13.04.2014 për lirimim e sendit, certifikatë pronësie dhe kartelë pasurie; -- lajmërim nr. {***} regj., datë 13.04.2021, për lirimim vullnetar të sendit të paluajtshëm në favor të blerësit; -- lajmërim nr. {***} regj., datë 13.04.2021, për lirimim vullnetar të sendit të paluajtshëm në favor të blerësit; -- vendim pushimi nr. {***} regj., datë 14.05.2021, i përmbaruesit gjyqësor për pushimin e ekzekutimit të urdhrit ekzekutiv nr. {***}, datë 05.10.2015; -- vendim nr. {***}, datë 30.05.2024, i Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Shkodër; -- vërtetim nr. {***}, datë 21.11.2023, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë; -- vendim për mosfillimin e procedimit penal, i datës 31.05.2021, i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë; -- praktika e ekzekutimit të vendimit nr. {***}, datë 10.03.2021, të Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, për të dënuarin I. H..

⁸ Denoncim i regjistruar në Kolegj me nr. {***} prot., datë 20.11.2023.

⁹ Paragrafët 84 dhe 84.1 të vendimi të Komisionit.

e procedimeve, vlerëson se nuk jemi përpara plotësimit të kriterëve për ta ngarkuar subjektin e rivlerësimit me përgjegjësi disiplinore, si dhe për t'u konsideruar si shkak për marrjen e masës së shkarkimit nga detyra.

14. Në konkluzionin e mësipërm, Komisioni ka arritur pasi është njohur nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme me masën disiplinore “Zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë 1 vit” dhënë subjektit të rivlerësimit me urdhrin nr. {***}, datë 08.02.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, si dhe pasi ka analizuar shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit lidhur me problematikën e konstatuar në 3 (tre) procedime penale¹⁰ ndër të cilët edhe procedimin penal nr. {***} të vitit 2003, që kanë çuar në dhënien e kësaj mase disiplinore.
15. Komisioneri Publik, në kundërshtim të konkluzionit të Komisionit, ka pretenduar në ankim se: [...] marrë në konsideratë se procedimi penal nr. {***} i vitit 2003 është regjistruar për veprën penale “Vrasje me paramendim” kryer në bashkëpunim dhe veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, ku marzhi minimal i dënimit fillon me burgim pesëmbëdhjetë vjet, dhe se ushtrimi i ndjekjes penale nuk parashkruhet pa kaluar njëzet vjet, vlerëson se shkelja e konstatuar në mosveprimin e subjektit të rivlerësimit, është e tillë që kualifikohet në ato që cenojnë besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
16. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, duke e konsideruar të drejtë arsyetimin e Komisionerit Publik në ankim, për sa lidhet me mosveprimin e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi që: “[...] shkeljet e subjektit të rivlerësimit në këtë procedim penal për shkak se është marrë një masë disiplinore të çmohen si rrethanë rënduese në kuptim të nenit 115 “Kriteret për caktimin e masës disiplinore” pika 4, germa “a” e ligjit nr. 96/2016”.
17. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar gjatë gjykimit në Kolegj shkakun e ankimit me pretendimin se nuk plotësohen kriteret për ngarkim me përgjegjësi disiplinore as në optikën e proporcionalitetit e as në standardin material të nenit 61, pika 5, lidhur me cenimin e besimit të publikut, sa kohë që çdo mangësi e identifikuar është sanksionuar disiplinarisht në parim dhe nuk është shndërruar asnjëherë në model sjelljeje të përsëritur, që të justifikonte masa të natyrës *ultima ratio*. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur sa vijon.

17.1 Procedimi penal nr. {***} i vitit 2003 është regjistruar më datë 13.06.2003, për veprat penale “Vrasje me dashje” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, të parashikuara nga nenet 76 dhe {***} të Kodit Penal dhe jo për “Vrasje me paramendim”.

17.2 Më datë 10.02.2004 është vendosur pezullimi i hetimeve për mosidentifikim autori dhe fashikulli origjinal i është përcjellë për kompetencë Drejtorisë së Policisë Shkodër. Pas pezullimit të hetimeve, procedimi penal nr. {***}/2003 i është përcjellë sërish subjektit të rivlerësimit, dorazi, për verifikim paraprak nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë. Nga subjekti shpjegohet se prej tij nuk është marrë vendim për rifillim, pasi i vetmi *element i ri* ishte një relacion i organit të policisë, i mbështetur thjesht në burime policore, si deklarime verbale të babait dhe xhaxhait të personit të

¹⁰ Procedimet penale nr. {***}/2000, nr. {***}/2005 dhe nr. {***}/2003.

dysshuar, të cilët pretendonin se ndodheshin në gjakmarrje/ngujim me arsytimin se i afërmi i tyre ishte autori i vrasjes. Këto pohime, të paformalizuara në formën e kërkuar ligjore para organit procedues, të cilat vinin nga të afërm të drejtpërdrejtë të të dyshuarit, në vlerësimin e subjektit, nuk përbënin indicie të mjaftueshme dhe të verifikueshme për rifillimin e hetimit.

17.3 Qasja e Komisionerit Publik, duke u nisur nga supozimi se procedimi penal i vitit 2003 është regjistruar për “Vrasje me paramendim” në bashkëpunim, shoqëruar me veprën “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve luftarake e municionit”, me marzh të lartë ndëshkimor dhe afate të gjata të parashkrimit të ndjekjes penale, dhe duke përfunduar me ngritjen e mosveprimit të subjektit në nivelin e *cenimit të besimit të publikut*, sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, e ngre rrezikshmërinë dhe regjimin e parashkrimit në nivel “prove” zëvendësuese, dhe jo një model të qëndrueshëm sjelljeje, që kërkon realisht kjo dispozitë ligjore.

17.4 Megjithëse subjekti duhet të kishte ndërmarrë formalisht rifillimin dhe marrjen në pyetje të personave të përmendur, në përputhje me nenin 158 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, në thelb bëhet fjalë për një devijim metodologjik, jo për një sjellje të qëllimshme apo sistematike dhe përgjegjësia që mund t’i atribuohet veprimeve të tij kufizohet në një mangësi thjesht procedurale.

17.5 Vërejtjet e konstatuara në procedimin penal nr. {***}/2003, së bashku me ato të evidentuara në procedimet nr. {***}/2000 dhe nr. {***}/2005 (për të cilat është vënë në dijeni Drejtuesi i Prokurorisë, kur është pyetur për çështjen e vitit 2003), u shqyrtuan në kohë nga Këshilli i Prokurorisë dhe u konkludua se nuk ka pasur asnjë element qëllimi, përfitimi apo prirjeje të njëanshme nga ana e tij.

18. Në shqyrtim të shkakut të ankimit, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton dhe vlerëson si më poshtë.

18.1 Në raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit¹¹, në pjesën “Të dhënat arkivore lidhur me ankesa, masa disiplinore dhe vlerësime”, evidentohet se: (i) me urdhrin nr. {***}, datë 30.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë subjektit të rivlerësimit Agron Bushati, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra e prokurorit”; (ii) me urdhrin nr. {***}, datë 08.02.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë subjektit të rivlerësimit masa disiplinore “zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë prej 1 (një) vit”.

18.2 Nga dokumentacioni mbi të dhënat arkivore të subjektit të rivlerësimit, përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme¹², rezulton se:

18.2.1 Me urdhrin nr. {***}, datë 30.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë prokurorit Agron Bushati, masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”, me arsytimin se: “Prokurori Agron Bushati ka pasur në hetim procedimin penal nr. {***} regjistruar

¹¹Referuar raportit nr. {***} prot., datë 22.06.2023, të Këshillit të Lartë të Prokurorisë për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, ndaj tij janë dhënë dy masa disiplinore: (i) me urdhër nr. {***}, datë 30.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për shkarkim nga detyra e prokurorit”; (ii) me urdhër nr. {***}, datë 08.02.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm i është dhënë masa disiplinore “Zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë prej 1 (një) vit”.

¹² Me shkresat nr. {***} prot., datë 14.05.2021 dhe nr. {***} prot., datë 07.09.2023.

në datën 06.04.2004 në ngarkim të të pandehurve S. dhe L. V. të akuzuar për veprën penale të vjedhjes me dhunë e parashikuar nga neni 139 i Kodit Penal. Nga ana e prokurorit Agron Bushati më datë 29.12.2004 është bërë shënimi në regjistër se procedimi penal është dërguar në gjyq. Nga verifikimi i bërë rezulton se procedimi i mësipërm penal nuk është dërguar në këtë datë në gjyq dhe është mbajtur në dorë pa kryer asnjë veprim deri më datën 20.10.2005. [...]”.

18.2.2 Me urdhrin nr. {***}, datë 11.10.2007, të Prokurorit të Përgjithshëm, është urdhëruar pezullimi nga detyra i prokurorit Agron Bushati, pasi ndaj tij ka nisur procedimi disiplinor për marrje mase disiplinore, me arsyetimin se: *“Prokurori Agron Bushati ka përfaqësuar në gjykim akuzat ndaj të pandehurve V. Sh. dhe A. Sh., të akuzuar për veprat penale të “Vrasjes me dashje” në bashkëpunim dhe “Armëmbajtjes pa leje”, të parashikuara nga nenet 78-25 dhe 278/2 të Kodit Penal. Gjykimi i kësaj çështjeje ka vazhduar gjatë vitit 2003. Më datën 23.01.2004 në qytetin e Shkodrës është djegur banesa e gjyqtarit T. S., ku në banesën e tij ndodhej edhe dosja e mësipërme gjyqësore në ngarkim të të pandehurve V. Sh. dhe A. Sh., e cila është dëmtuar pjesërisht nga djegia. Gjatë vitit 2005 deri në fillim të vitit 2006 kjo dosje nuk është vënë në lëvizje nga prokurori Agron Bushati. Në muajin shkurt të vitit 2006, pas një informacioni që ka ardhur në prokurori për fatin e dosjes së mësipërme, është vënë në lëvizje Prokuroria dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe është organizuar një takim në gjykatë, me qëllim për t’i dhënë zgjidhje ligjore kësaj çështje të ngelur pezull. Më datën 29.03.2006, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, bazuar në nenin 102 të Kodit të Procedurës Penale, ka vendosur të ribëjë procesverbalin e seancës gjyqësore të datës 16.12.2003 të dosjes penale në ngarkim të pandehurve V. Sh. dhe A. Sh.. Sipas pjesës arsyetuese të këtij vendimi, rezulton se më datën 16.12.2003, para se të dëmtohej dosja, gjykata ka vendosur kthimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër. Më datën 02.05.2006, Gjykata e Rrethit Shkodër, me shkresën nr.{***}, datë 02.05.2006, i ka kthyer Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dosjen gjyqësore në ngarkim të të pandehurve V. Sh. dhe A. Sh.. Kjo dosje i është dhënë për veprim prokurorit Agron Bushati. Pasi ka marrë dosjen në muajin maj 2006 e deri aktualisht prokurori Agron Bushati nuk ka kryer asnjë veprim duke e mbajtur atë në kasafortë. Nga kontrolli i ushtruar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër më datën 26.09.2007, rezulton se prokurori Agron Bushati ka mbajtur në kasafortë pa dorëzuar procedimet penale nr.{***} i vitit 2000, {***} i vitit 2003 dhe {***} i vitit 2005”.*

18.2.3 Me urdhrin nr. {***}, datë 11.10.2007, të Prokurorit të Përgjithshëm, duke u konsideruar shkelje të rënda disiplinore veprimet e mësipërme, është urdhëruar fillimi i procedimit disiplinor ndaj prokurorit Agron Bushati për marrje mase disiplinore *“Shkarkim nga detyra”*.

18.2.4 Në relacionin *“Mbi procedimin disiplinor në ngarkim të prokurorit Agron Bushati”*, hartuar nga Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit pranë zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm, parashtrohen shkeljet e kryera nga prokurori Agron Bushati në lidhje me tre procedime penale që i përkasin viteve 1998¹³, 2003 dhe 2005, të cilat ishin mbajtur nga subjekti i rivlerësimit në kasafortë pa u kryer veprime, ndër të cilët, edhe procedimi penal nr. {***} i vitit 2003, për të cilin parashtrohen rrethanat e faktit si vijon: *Procedimi penal nr. {***} regjistruar më datë 13.06.2003, për veprën penale të vrasjes dhe armëmbajtjes pa leje, në bazë të neneve 76 e 278/2 të Kodit Penal, janë*

¹³ *Procedimet penale nr. {***}/1998 dhe {***}/1998 janë bashkuar në një çështje të vetme, dërguar për gjykim në vitin 2000.*

pezulluar hetimet në datën 10.02.2004, në mbështetje të nenit 326/1 dhe 2 të Kodit të Procedurës Penale. Nga studimi i akteve të administruara në dosje rezulton se: Në datën 18.06.2003 në orët e mbrëmjes, në lagjen {***}, në Shkodër, është vrarë me armë zjarri shtetasi Sh. Ç., duke qenë brenda një autoveture “Renault”, me targë {***}. Nga veprimet e para hetimore të kryera prej oficerëve të policisë gjyqësore të Komisarariatit të Policisë Shkodër, kanë dalë prova pothuajse të plota se vrasjen e kishte kryer shtetasi Sh. M. Y., e megjithatë policia nuk e ka gjetur dhe nuk e ka arrestuar në flagrancë këtë person. Sipas deklaruësit S. H., autori është larguar familjarisht dhe është ngujuar nga frika e hakmarrjes, në një vend, por që nuk dihej prej deklaruësit. Më datën 13 qershor 2003, të gjitha aktet procedurale të kësaj ngjarje, bashkëlidhur me informacionin e policisë kanë ardhur në Prokurori të Rrethit Shkodër, datë kjo ku prokurori i rrethit U. M. i ka deleguar çështjen prokurorit Agron Bushati. Në datën 19.06.2003, prokurori Agron Bushati përpilon urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore P. L., duke përcaktuar edhe një afat deri në datën 20.07.2003. Në fakt deri në këtë datë nuk është kryer asnjë veprim hetimor. Të vetmet veprime të kryera mbas marrjes së çështjes për hetime nga prokurori Agron Bushati janë dy procesverbale deklarimi datë 05.11.2003 nga shtetasi N. e I. Ç., vëllezërit e viktimës dhe një vendim sekuestrimi për veturën e përmendur më sipër, si provë materiale, e bllokuar mbasi ishte objekti ku ndodhi krimi. Më pas, pasi janë administruar në dosje edhe dy akte nr. {***} teknik-balestik dhe nr. {***} vlerësim prove. Më datën 10.02.2004, çështja është pezulluar nga prokurori Agron Bushati dhe ajo është mbajtur në kasafortë nga ana e prokurorit Agron Bushati për një periudhë prej 2 vjet e gjysmë deri sa është gjetur në kasafortë pas një kontrolli që është ushtruar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër”. Shkeljet ligjore të kryera nga prokurori Bushati renditen si vijojnë.

a) Nuk ka nxjerrë urdher ndalimi për shtetasin Sh. M. Y. për krimin e vrasjes dhe armëmbajtjes pa leje në zbatim të nenit 253 të Kodit të Procedurës Penale menjëherë mbas marrjes së çështjes për veprim dhe t’ia dërgonte për ekzekutim Komisarariatit të Policisë Shkodër. Gjithashtu, nuk ka bërë kërkesë në Gjykatën e Rrethit Shkodër, për masë sigurimi arrest në burg, në ngarkim të këtij personi, ndonëse kishte prova të plota për arrestimin e tij. Konkretisht vëllai i viktimës I. Ç. i ka deklaruar policisë se gjatë varrimit të vëllait i kanë thënë se autori i vrasjes ishte Sh. M. Y., por edhe vetë ky e ka parë skenën e vrasjes në një distancë rreth 10 m larg dhe po ta shohë autorin është në gjendje ta njohë. Dëshmitari S. H. ka deklaruar se në prani edhe të babait të tyre, motra e vet, e cila është martuar me vëllanë e autorit, ju ka thënë se vëllai i burrit Sh. Y. kishte vrarë Sh.. Veç sa më sipër edhe vëllai i autorit H. Y., në deklarinimet e tij është shprehur se fill pas ngjarjes së ndodhur ju ka thënë në shtëpinë e vet familjes së tij se: mbylluni brenda se Sh. ka vrarë një shtetas dhe më pas është larguar nga banesa e vet duke u strehuar tek baxhanaku i tij Y. S..

b) Nuk ka marrë vendim për marrjen të pandehur në mungesë të këtij personi për krimin e vrasjes, ndonëse nga aktet e para të marra nga policia, ka shumë prova që tregojnë se ai është autori që e ka kryer këtë vrasje. Kjo vërtetohet me deklarinimet e dëshmitarëve I. Ç., S. H. dhe vëllai i autorit, H. Y., të cilët e kanë nxjerrë pothuajse të plotë faktin që këtë vrasje e ka bërë Sh. M. Y.. Veç këtyre provave, në dosje është fiksuar edhe një provë tjetër indirekte. Në veturën e viktimës, në bagazhin e saj u gjetën një sasi e konsiderueshme qepë të njoma edhe kunguj të cilat ishin vjedhur në bahçen e autorit natën e ngjarjes, të deklaruara këto edhe nga S. H.. Sipas këtij dëshmitari autori i vrasjes fillimisht ka bërë fjalë me viktimën, duke i thënë që të kthehej te baça dhe ti linte atje qepët dhe

kungujt që kishte vjedhur, por viktima nuk kishte pranuar. Kjo u bë shkak që mbas këtij konflikti ndodhi vrasja.

c) Hetimet e kryera për këtë ngjarje janë me mangësi të theksuara, jo vetëm për ato veprime procedurale, të cilat patjetër duheshin kryer direkt nga prokurori Agron Bushati, por edhe shumë të tjera që duhet të kryheshin nga oficeri i policisë gjyqësore, me urdhër të prokurorit, p.sh. të pyeteshin të gjithë ata shtetas të cilëve ju ka dalë emri, se kanë dijeni për këtë vrasje si Y. S. etj. Të hetohej lidhur me perimet e freskëta që ju gjetën viktimës në bagazhin e autoveturës, të cilat ishin vjedhur atë natë nga viktima, në bahçen e autorit dhe që u bënë shkak për konfliktin midis autorit Sh. Y. dhe viktimës Sh. Ç., e më pas edhe shkak i vrasjes. Në këtë drejtim duhej hetuar nëse ka edhe motive të tjera për këtë vrasje apo jo, çfarë njohje dhe lidhje të mëparshme kanë pasur viktima me autorin ose familjet e tyre etj. Në rast se do ishin kryer të gjitha këto veprime hetimore që përmendëm më lart, përfundimisht dosja duhej dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Shkodër, në ngarkim të të pandehurit Sh. M. Y., me akuzën për vrasje me dashje në bazë të neneve 76 e 278/2 të Kodit Penal.

ç) Në vendimin e pezullimit vihet re një argumentim i dobët nga ana profesionale, jo me objektivitet dhe dukshëm me mangësi të theksuara. Në këtë vendim nuk gjejmë pasqyrim provat e administruara në dosje, në ngarkim të autorit, të cilat janë shumë të qarta, por evidentohen kryesisht aktet balesrike ose mjekoligjore të administruara në dosje. Në fund të këtij vendimi arsyetohet moszbulimi i autorit vetëm mbi bazën e disa shprehjeve të veçanta të vëllait të viktimës, i cili midis të tjerave ka thënë gjithashtu se sipas zakonisht ata nuk e dinë kush është autori, mbasi nga familja e tyre nuk ju është dërguar fjalë.

18.2.5 Këshilli i Prokurorisë, në mbledhjen e datës 23.01.2008, pasi mori në shqyrtim materialet e paraqitura nga Drejtoria e Personelit dhe Inspektimit të Prokurorisë së Përgjithshme për shkeljet e kryera nga prokurori Agron Bushati, pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe dëgjoi vetë prokurorin, i cili pranoi shkeljet e evidentuara në relacionin e kësaj drejtorie, vendosi t'i sugjerojë Prokurorit të Përgjithshëm mendimin si vijon: *Shkeljet disiplinore, për të cilat akuzohet prokurori Agron Bushati, qëndrojnë, por duke vlerësuar në tërësi punën e këtij prokurori, rëndësinë e shkeljeve dhe pasojat e ardhura, ndaj tij të merret një masë më e lehtë disiplinore, por jo shkarkim nga detyra dhe njëkohësisht të transferohet nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër në një rreth tjetër.*

18.2.6 Me urdhrin nr. {***}, datë 08.02.2008, Prokurori i Përgjithshëm ka vendosur dhënien e masës disiplinore “Zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë prej 1 (një) viti”, duke u transferuar për këtë periudhë pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë. Në përmbajtje të këtij urdhri parashtrahet se: *Nga kontrolli i ushtruar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër më datën 26.09.2007, rezulton se prokurori Agron Bushati ka mbajtur në kasafortë pa dorëzuar procedimet penale nr. {***} i vitit 2000, {***} i vitit 2003 dhe {***} i vitit 2005. Shkeljet konkrete të kryera nga prokurori Agron Bushati janë evidentuar hollësisht në relacionin e procedimit disiplinor në ngarkim të tij. Këto shkelje janë pranuar nga prokurori Agron Bushati.*

18.3 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni, pasi ka konstatuar, referuar dokumentacionit si më sipër, se nga kontrolli i ushtruar më datë 26.09.2007 nga Drejtuesi i

Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit ka mbajtur në kasafortë pa dorëzuar procedimet penale nr. {***/2000, nr. {***/2003 dhe nr. {***/2005, ka arritur në konkluzionin paraparak se: *Duket se subjekti ka zvarritur procedimet penale për periudha të gjata kohore.*

18.4 Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“Procedimi penal {***/2003, për të cilin parimisht kam marrë masën disiplinore, është regjistruar më datë 13.06.2003, për veprën penale “Vrasje me dashje” dhe “Mbajtja pa leje e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 76 dhe 278/2 të Kodit Penal. Me vendimin e datës 10.02.2004 është vendosur pezullimi i hetimeve të procedimit penal nr. {***/2003, për moszbulim të autorit. (fashikulli origjinal i është dërguar për kompetencë Drejtorisë së Policisë Shkodër, praktikë e cila është ndjekur në atë kohë me të gjitha rastet e pezullimit). Dosja më është dhënë sërish dorazi për studim nga drejtuesi i prokurorisë U.M (disa ditë përpara transferimit të tij dhe zëvendësimit nga drejtuesi pasardhës). Lidhur me këtë dosje unë nuk kam marrë vendim rifillimi, pasi kam pasur dyshimet e mia nëse ekzistonin realisht kushtet për rifillimin e hetimeve. Kjo pasi, relacioni për rifillim i policisë i referohej vetëm burimeve policore, sipas të cilave, babai dhe xhaxhai i të dyshuarit në atë kohë deklarorin se ishin në gjakmarrje/të ngujuar për shkak se familjari i tyre ishte autori i vrasjes. Pra, kishim të bënim me pohime të familjarëve të autorit të prezumuar si i dyshuar, të dhëna verbalisht dhe jo në formën e duhur ligjore para autoriteteve ligjzbatuese. Një informacion i tillë është marrë me rezervë nga ana ime, nuk më është dukur i besueshëm pasi nuk ishte e logjikshme që vetë familjarët (babai dhe xhaxhai i të dyshuarit) ta inkriminonin familjarin e tyre dhe në optikën time ishte një tentativë për të fituar azil jashtë Shqipërisë, nuk ofronte garanci që këto pohime së pari ishin të vërteta dhe së dyti që këto pohime do të jepeshin nga shtetasit në fjalë në momentin që do të thirreshin për t’u pyetur nga Prokuroria apo nuk do të ndryshoheshin më vonë gjatë gjykimit. Përgjegjësia ime qëndron vetëm në faktin se, sado e palogjikshme që ishte situata, duhej ta kisha tentuar rifillimin dhe marrjen në pyetje të këtyre shtetasve, duke zbatuar dispozitat e nenit 158 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, pavarësisht bindjes sime nëse një veprim i tillë do të sillte apo jo rezultat pozitiv. Si përfundim, në mënyrë të përmbledhur, lidhur me tre rastet e cituara më lart sqaroj se procedimet {***/2000 dhe {***/2005 janë procedime për të cilat unë e kam vënë në dijeni Drejtuesin e Prokurorisë, në momentin që më është kërkuar informacion lidhur me procedimin penal nr. {***/2003. Nuk ka qenë konstatim i askujt, por kam qenë unë ai, i cili, kam vënë në dijeni lidhur me faktin se përveç procedimit në fjalë kisha dhe dy procedime të tjera, të cilat duheshin rifilluar. Pikërisht këto rrethana të paraqitura “ndryshe” nga grupi i inspektimit në atë periudhë, paraqitur sikur unë i kisha mbajtur qëllimisht në kasafortë 3 procedimet në fjalë, në fakt për dy nga këto tre procedime, është marrë dijeni nëpërmjet meje. Gjithsesi, këto rrethana janë sqaruar gjatë shqyrtimit në Këshillin e Prokurorisë dhe është konkluduar se asgjë nuk ka qenë e qëllimshme apo me dashje nga ana ime, apo për përfitime të asnjë lloj natyre”.*

18.5 Në mbështetje të shpjegimeve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur shkresën nr. {***/2007, datë 08.11.2007, të Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit në Prokurorinë e Përgjithshme drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, përmes së cilës kthehen procedimet penale me nr. {***/2000, nr. {***/2003 dhe nr. {***/2005, me porositë si vijojnë: *“1. Procedimi penal nr. {***/2000, i pezulluar më datën 19.06.2002, të rifillojnë hetimet*

*dhe të merret vendim pushimi i çështjes në bazë të nenit 66 të Kodit Penal, pasi është parashkruar ndjekja penale për veprën penale të vjedhjes neni 134/1,2 të Kodit Penal; 2. Procedimi penal nr. {***} i pezulluar në datën 10.02.2004, të rifillohen hetimet dhe të kryhen veprimet hetimore të domosdoshme; 3. Procedimi penal nr. {***} i pezulluar në datën 10.10.2006, të rifillohen hetimet dhe të kryhen veprimet hetimore të domosdoshme”.*

19. Në vlerësim të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik, në lidhje me procedimin penal nr. {***}, të vitit 2003, trupit gjykues, referuar dokumentacionit të administruar në fashikullin e Komisionit¹⁴, i rezultoi se ky procedim është regjistruar më datë 13.06.2003, për veprën penale “Vrasja me dashje”, e parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal, si dhe për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe e municionit”, e parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal. Pas regjistrimit të procedimit penal, subjekti i rivlerësimit ka përpiluar në datën 19.06.2003 urdhrin për kryerjen e veprimeve hetimore nga oficeri i policisë gjyqësore. Nga ana tjetër, evidentohet se të vetmet veprime hetimore të kryera prej tij për këtë ngjarje të rëndë janë dy procesverbale deklarimi të datës 05.11.2003, që i përkasin vëllezërve të viktimës, një vendim sekuestrimi automjeti, si dhe janë administruar më pas dy akte *teknikë- balistik* dhe *vlerësim prove*. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pezullimin e hetimeve në datën 10.02.2004 dhe dosja është mbajtur në kasafortë prej tij për një periudhë prej 2 (dy) vjet e gjysmë, deri sa është gjetur më datë 26.09.2007, nga Drejtuesi i Prokurorisë Shkodër, pas kontrollit të ushtruar nga ky i fundit, së bashku me dy procedimet penale me nr. {***} i vitit 2000 dhe {***} i vitit 2005, të cilat ishin mbajtur, gjithashtu, në kasafortë. Në përfundim të hetimit disiplinor të kryer si pasojë e mosveprimeve të subjektit të rivlerësimit edhe në këtë çështje, me urdhrin nr. {***}, datë 08.02.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjektit të rivlerësimit i është dhënë masa disiplinore “Zbritje në detyrën e oficerit të policisë gjyqësore për një periudhë prej 1 (një) viti”, e ai është transferuar pranë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Pukë. Kjo situatë faktike, për të cilën subjekti ka marrë një masë disiplinore si më sipër referuar, si pasojë e mungesës së veprimit të trefishtë nga ana e tij, nuk i është nënshtruar shqyrtimit në kuadër të gjyqimit të kësaj çështjeje në Kolegj, por trupi gjykues e mbajti në konsideratë si një aspekt që përbën tregues të aftësisë së tij për reflektim e vetëkorrektim apo vazhdimësi pasqyrimi të të njëjtave qasje pavarësisht nga qenia i ndërgjegjshëm i mangësive në kryerjen e detyrës në vijimësi, përfshirë edhe deri në momentin e shqyrtimit të këtij ankimi në Kolegj.

Në lidhje me denoncimin e shtetasit Kolë Bjanku

20. Komisioni, në vendim, në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, ka arritur në konkluzionin¹⁵ *se bazuar në dosjen e ankesës nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për të treguar veprime të njëanshme apo korruptive nga subjekti i rivlerësimit.*
21. Komisioneri Publik, në ankim, ndryshe nga Komisioni, ka pretenduar se shkelja e konstatuar në mosveprimin e subjektit të rivlerësimit ndaj një kallëzimi të paraqitur në organin e prokurorisë nga denoncuesi, duke mos e shënuar atë në regjistër, është e tillë që kualifikohet në ato që cenojnë

¹⁴ Referuar relacionit të Drejtorisë së Personelit dhe Inspektimit pranë Zyrës së Prokurorit të Përgjithshëm në ngarkim të prokurorit Agron Bushati dhe praktikës dokumentare të masës disiplinore të përcjellë në Komision nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. {***} prot., datë 07.09.2023.

¹⁵ Shih paragrafin 90.1 të vendimit të Komisionit.

besimin e publikut te drejtësia, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Në argumentimin e këtij pretendimi, Komisionerja Publike i referohet: (i) vendimit të Gjykatës së Lartë, me nr. {***}, datë 23.04.2014, sipas së cilit, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 17.10.2012, ka konstatuar se: [...] *Agron Bushati me funksion publik të prokurorit, nuk ka kryer veprime që ligji, e pikërisht neni 287 i Kodit të Procedurës Penale e detyron t'i kryejë, siç është ai i shënimit në regjistër i njoftimit të veprës penale të marrë nëpërmjet kallëzimit të mbërritur, me shkresën nr. {***} prot., datë 24.09.2002, të Komisarariatit të Policisë Shkodër. Çka qartazi përbën mospërbushje të rregullt të detyrës së tij për “[...] zhvillimin brenda kompetencave të caktuara të hetimeve të nevojshme, që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale” (pika 1, neni 277 i Kodit të Procedurës Penale) njëri nga të cilët është edhe “regjistrimi i njoftimit të veprës penale”, të cilën ai nuk e ka kryer. [...] Po ashtu, e hapur është edhe pasoja e “dëmtimit të interesave të ligjshme të shtetit” të disiplinimit të kryerjes së hetimeve të nevojshme për ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe i interesave të ligjshme të qytetarit K. B., si i dëmtuar nga vepra penale e kanosjes, për procedimin e fajtorit (pika 1, neni 58 i Kodit të Procedurës Penale), të cilën ai mbi bazën e pikës 1, të nenit 283, të Kodit të Procedurës Penale, ka kallëzuar si vepër penale që ndiqet kryesisht nga prokuroria dhe policia gjyqësore. [...]; (ii) procesverbalit për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale të datës 22.12.2008, në të cilin, subjekti i rivlerësimit, pyetjes së prokurorit A. K., se çfarë kujton nga kallëzimi i shtetasit K. B. ndaj shtetasit A. P., i është përgjigjur se nuk është në gjendje të kujtojë asgjë në lidhje me kallëzimin e bërë nga shtetasi K. B., pasi bëhet fjalë për një hark kohor të konsiderueshëm.*

22. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, konfirmoi në parashtrime qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim dhe, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, vlerësoi se pas debatit gjyqësor në Kolegj, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se nuk ka nënshkruar në regjistër për marrjen në dorëzim të kallëzimit penal të shtetasit K. B. nuk gjen mbështetje nga rrethanat faktike të dala nga hetimi administrativ në Komision, duke iu referuar informacionit të përcjellë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.04.2023, përmes së cilës përcillen dosjet gjyqësore në emër të denoncuesit K. B..

23. Subjekti i rivlerësimit, në kundërshtim të shkakut të ankimit, ka argumentuar se:

i. Konstatimi i Gjykatës së Lartë për detyrimin formal të regjistrimit të kallëzimit është në thelb një error in procedendo; ai nuk mund të lexohet apriori si “cenim i besimit të publikut”, në kuptimin e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016. Barazimi mekanik i çdo mangësie procedurale me papërshtatshmëri etike apo profesionale do ta shndërronte kontrollin kasacional në një automatikë disiplinore, në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit dhe me natyrën ultima ratio të shkarkimit.

ii. Teza e “dëmtimit të interesave të ligjshme të shtetit dhe të të dëmtuarit” nuk mbështetet, sepse vetë arkitektura e mjetit juridik në instancat më të larta ekziston pikërisht për korrigjimin e gabimeve dhe mbrojtjen e këtyre interesave. Të kërkuar pagabueshmëri të pandërprerë nga instancat më të ulta dhe të ngresh çdo devijim procedural në “cenim të besimit publik” do të prodhonte pasiguri institucionale dhe do të cenonte lirinë e bindjes së brendshme në ushtrimin e funksionit. Pa prova për qëllim, përsëritje, përfitim apo anim, pragu material i nenit 61/5 nuk tejkalohet.

iii. Mbështetja e Komisionerit te fakti që subjekti, i pyetur si person që ka dijeni pas një harku të gjatë kohor, nuk ka mundur të rikujtojë detaje të një kallëzimi të hershëm është vlerësim i njëanshëm dhe tejet subjektiv, nuk është as realist e as juridikisht i mbrojtshëm të kërkohet memorizim i plotë i çdo rasti të trajtuar ndër vite dhe, aq më pak, që kjo të përdoret si tregues agravues drejt shkarkimit.

iv. Rasti i vitit 2002 u sqarua edhe para Komisionit, materiali kallëzues përbëhej nga rreth një faqe e gjysmë, në atë kohë procedura parashikonte regjistrimin në kryesekretari dhe shpërndarjen për vlerësim; nga verifikimet e mëvonshme rezulton se materiali nuk është marrë kurrë dorazi nga subjekti (figuron vetëm emri, jo nënshkrimi i marrjes), ndaj atribuimi i përgjegjësisë i “humbjes së fashikullit” mungon në bazë provash.

v. Pretendimet penale për “Shpërdorim detyre” [neni 248 i Kodit Penal dhe “Zhdukje ose humbje fashikulli” (neni 313/a Kodit Penal)] janë hetuar në themel nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe kanë përfunduar pa konstatuar shkelje penale nga subjekti, gjetje që përputhet me konkluzionin e KPK-së se nuk ka rrethana që dëshmojnë veprime të njëanshme ose korruptive.

24. Në shqyrtim të shkakut të ankimit, nga aktet e administruara nga Komisioni gjatë hetimit administrativ, trupi gjykues konstaton se:

24.1 Në denoncimin e adresuar në Komision nga shtetasi K. B.¹⁶, ngrihen pretendime se subjekti i rivlerësimit është i korruptuar, pasi ka zhdukur një denoncim të depozituar prej tij në organin e prokurorisë. Denoncuesi i ka bashkëlidhur denoncimit të tij aktet shkresore si vijojnë: (i) disa faqe të vendimit nr. {***}, datë 17.10.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër; (ii) rekurs i datës 26.05.2014, paraqitur nga denoncuesi në Gjykatën e Lartë; (iii) kërkesë e denoncuesit drejtuar ambasadorit të ShBA-së në Shqipëri.

24.2 Gjatë hetimit administrativ, me qëllim verifikimin e pretendimeve të ngritura në këtë denoncim, Komisioni ka administruar fashikullin e kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2010, që i përket shtetasit K. B., përcjellë nga Prokuroria¹⁷ dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë¹⁸, nga aktet e të cilit rezulton se:

24.2.1 Më datë 03.12.2008, shtetasi K. B. ka depozituar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër kallëzim penal që mban numrin {***} të vitit 2008 ndaj prokurorit Agron Bushati, duke pretenduar se ai ka zhdukur dhe nuk ka pasqyruar në regjistër një kallëzim penal që kishte depozituar në vitin 2002 ndaj shtetasit A. P., inspektor në Bashkinë Shkodër. Nga verifikimet e kryera nga prokurori i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër A. K., në lidhje me këtë kallëzim penal, ndër të tjera, evidentohet se:

i. Referuar procesverbalit për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale të datës 18.12.2008, kallëzuesi K. B. ka deklaruar se: [...] Kjo kërkesë imja ka të bëjë me një kallëzim penal të bërë nga unë ndaj një inspektori të Bashkisë Shkodër, A. P., për veprën penale të kanosjes

¹⁶ Regjistruar në Komision me nr. {***} prot., datë 05.10.2018.

¹⁷ Me shkresën nr. {***} prot., datë 05.04.2023.

¹⁸ Shkresë kthim përgjigje nr. {***} prot., datë 05.04.2023.

*në Komisarariat e Policisë Shkodër në vitin 2002, kallëzim, i cili, është përcjellë zyrtarisht në Prokurorinë e Rrethit Shkodër me shkresën nr. {***} prot., datë 13.08.2002. Pas pesë apo gjashtë ditësh kam ardhur në prokurori ku kryesekretarja e saj më ka thënë se ky kallëzim nuk ka ardhur akoma këtu. Kam vajtur menjëherë në Komisarariat e Policisë dhe kam takuar oficerin e policisë gjyqësore R. B. që kam bërë kallëzimin dhe ai më ka dhënë numrin dhe datën e shkresës që citova më lart, pasi bëri verifikimin e regjistrit. Nga ky person më është thënë se kallëzimin ja kishte dorëzuar personalisht prokurorit Agron Bushati. Pas kësaj kam ardhur sërish në prokurori ku ritakova k/sekretaren Z. S., të cilës i shpjegova se kallëzimi është në prokurori e se e ka prokurori Agron Bushati. Kjo shtetase në prani të Agron Bushatit ka kontrolluar regjistrin dhe më është thënë nga ajo se në regjistër nuk figuronte ky kallëzim e se do të kontrollonte edhe regjistrat e tjerë. Meqenëse më thanë që të vija një ditë tjetër, unë e kam bërë këtë për një periudhë rreth gjashtë muaj, thujse çdo ditë e në orare të ndryshme, por pa rezultat pasi ky kallëzim nuk u gjend në prokurori. Them se nuk u gjet, pasi nga prokurori Agron Bushati më është thënë në zyrën e tij se kallëzimi ka humbur, por unë i thashë që nuk ka humbur, por e keni zhdukur ju, pasi ju e keni marrë me firmë atë dhe nuk e keni pasqyruar në regjistër.*

ii. Referuar procesverbalit për marrjen e të dhënave nga personi që ka dijeni për veprën penale të datës 22.12.2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: *“Nuk jam në gjendje që të kujtoj asgjë në lidhje me kallëzimin e bërë nga shtetasi K. B.. Në rastin konkret bëhet fjalë për një hark kohor të konsiderueshëm dhe, për këtë shkak, e kam të pamundur që të rikujtoj rrethanat e paraqitjes së këtij shtetasi në organin e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër, objektin e kallëzimit penal dhe personave të cilëve iu është adresuar ky kallëzim. Personalisht nuk kujtoj dhe nuk njoh person konkret me emrat që ju cituat në pyetjen Tuaj, pra, personat me emrin K. B. dhe A. P.. Unë kam ushtruar profesionin si prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër në periudhën 15.03.2001 deri më datë 10.10.2007 dhe gjatë gjithë kësaj periudhe, duke iu referuar edhe datës 13.08.2002 ku nga shtetasi K. B. pretendohet se është depozituar një kallëzim penal, nuk kam pasur kontakt apo ndonjë reklamim nga shtetasi i lartpërmendur”.*

iii. Nga aktet e administruara evidentohet shkresa me nr. {***} prot., datë 13.02.2002, e Komisarariatit të Policisë, me lëndë *“Dërgohet denoncimi i shtetasit K. B.”*, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Shkodër dhe një faqe e regjistrit të Komisarariatit të Policisë Shkodër, në të cilin, në kolonën përkatëse të *“Numrit të dokumentit”*, evidentohet numri i shkresës {***}, dërguar Prokurorisë Shkodër dhe, përbri saj, në kolonat *“Vendi ku dërgohet”* dhe *“Nënshkrimi i marrësit”*, evidentohen respektivisht emri i prokurorit Agron Bushati, i shkruar me shkrim dore, si dhe nënshkrimi i marrësit përbri emrit të tij.

24.2.2 Në përfundim të verifikimeve të kryera lidhur me këtë kallëzim penal, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër, prokurori A. K., më datë 23.12.2008, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal nr. {***}, datë 03.12.2008, duke arsyetuar se: *“[...]rezulton e provuar se shtetasi K. B. ka bërë një kallëzim në gusht të vitit 2002 ndaj inspektorit të Bashkisë Shkodër A. P. për veprën penale të kanosjes, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, tek seksioni i ShKB-së në Komisarariatit të Policisë Shkodër. Ky kallëzim është përcjellë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër me shkresën nr. {***}, datë 13.08.2002, dhe është marrë kundrejt nënshkrimit nga prokurori i kësaj prokurorie Agron Bushati për verifikim. [...] Nga verifikimet e kryera nga ana jonë është vërtetuar se prokurori Agron Bushati e ka marrë këtë kallëzim dhe nuk e ka regjistruar në prokurori atë,*

por që nga koha e marrjes së kallëzimit, pra, datës 13.08.2002 e deri në bërjen e kallëzimit më datë 03.12.2008 kanë kaluar me shumë se pesë vjet, duke na vendosur në këtë mënyrë para kushteve ligjore të parashikuara nga neni 66 pika “c” e Kodit të Procedurës Penale, pra, vepra penale e kallëzuar është parashkruar”. Ky vendim është kundërshtuar nga shtetasi K. B. në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Shkodër, e cila, me vendimin nr. {***}, datë 15.01.2009, ka vendosur rrëzimin e kërkesës së z. B. dhe lënien në fuqi të vendimit të organit të prokurorisë, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale, sipas nenit 66 të Kodit Penal.

24.2.3 Pas ushtrimit të ankimit ndaj vendimit të mësipërm, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 01.07.2009, ka vendosur ndryshimin e tij, duke shfuqizuar vendimin e datës 23.12.2008, të organit të prokurorisë, për shkak të moskompetencës dhe dërgimin e çështjes prokurorisë kompetente pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se: *“Lidhur me themelin e çështjes, Gjykata e Apelit konstaton se prokurori, ndonëse ka refuzuar të fillojë procedimin penal me arsyetimin se ndjekja penale për veprën e kryer është parashkruar, nga pjesa arsyetuese e këtij vendimi nuk rezulton që: 1. Të jetë arritur në konkluzionin se është kryer një vepër penale, dhe; 2. Cila është vepra penale e kryer. Gjykata e Apelit rikujton se, është prokurori organi që me ligj është ngarkuar të ushtrojë ndjekjen penale. Në këtë kontekst, pavarësisht cilësimit ligjor që personat e ndryshëm mund t’u japin fakteve, që ata parashtrajnë në kallëzim, në fund është prokurori ai që pasi ka sqaruar të gjitha rrethanat e faktit, merr vendimin e duhur lidhur me hetimin e çështjes. Edhe në rastin konkret prokurori, pasi të vlerësojë të gjitha faktet e parashtruara nga kallëzuesi, në ushtrim të detyrës së tij, duhet të bëjë cilësimin e drejtë të tyre dhe më pas mund të arrihet në një përfundim të drejtë lidhur me çështjen”.*

24.2.4 Në zbatim të vendimit të mësipërm të Gjykatës së Apelit Shkodër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka urdhëruar fillimisht më datë 23.09.2009, regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal¹⁹, ndërsa më pas, me vendimin e datës 24.09.2009, kjo prokurori ka vendosur të shpallë moskompetencën për hetimin e procedimit penal nr. {***} të vitit 2009 dhe kalimin e akteve Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Kjo e fundit, me urdhrin e Prokurorit të Rrethit të datës 02.10.2009, ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {***}, për veprën penale “Shpërdorim detyrë”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe kryerjen e hetimeve për këtë procedim penal nga prokurori Bardhok Lleshi. Pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes dhe caktimin e kompetencës së procedimit penal nr. {***} të vitit 2009, nga ana e Prokurorisë së Përgjithshme²⁰, e cila ia kaloi çështjen Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, kjo e fundit, me vendimin e datës 11.01.2010, ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, mbi bazën e kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2009, duke arsyetuar se: *“Pas studimit dhe analizimit të akteve të kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2009, rezulton se shtetasi K. B. ka bërë kallëzim në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër në lidhje me një kanosje që i është bërë atij nga shtetasi A. P.. Ai ka shpjeguar se kallëzimin e tij e ka bërë para OPGJ-së R. B., i cili i ka thënë se kallëzimin ia ka dorëzuar prokurorit Agron Bushati, dhe që prej vitit 2002 nuk ka marrë përgjigje për kallëzimin e bërë prej tij. Më datë 18.12.2008, shtetasi K. B. ka bërë kallëzim në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, duke akuzuar prokurorin Agron Bushati se ky i fundit*

¹⁹ Kjo dispozitë parashikon veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”.

²⁰ Sipas vendimit të datës 08.12.2009 të Drejtorisë së Kontrollit të Hetimit dhe Ndjekjes Penale në Prokurorinë e Përgjithshme.

ka humbur kallëzimin e tij. Duke analizuar veprimet e kryera për llogari të këtij kallëzimi penal rezulton se jemi para elementëve të parashikuara nga neni 313/a të Kodit Penal [...]. Duke pasur parasysh masën e dënimit që parashikon neni 313/a i Kodit Penal, që është maksimum deri në 5 vjet burg, afatin kohor kur ka ndodhur vepra që është viti 2002, rezulton të jemi në kushtet e nenit 66 pika “c” e Kodit Penal dhe, për pasojë, ndjekja penale për këtë vepër është shuar. [...]”. Ky vendim është kundërshtuar nga shtetasi K. B. në Gjykatën e Shkallës së Parë Lezhë, e cila, me vendimin nr. {***}, datë 10.03.2010, vendosi pushimin e gjyqimit të çështjes penale.

24.2.5 Ndaj vendimit të mësipërm të gjykatës ka ushtruar ankim shtetasi K. B., i cili, gjithashtu, ka kallëzuar sërish më datë 21.09.2010, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, prokurorin Agron Bushati, për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, për shkak se në detyrën e prokurorit ka humbur kallëzimin e bërë nga ana e tij në vitin 2002. Lidhur me ankimin e shtetasit K. B., Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 18.10.2010, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {***}, datë 10.03.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe kthimin e akteve për rigjykim në këtë gjykatë, por me një tjetër trup gjykues, duke arsyetuar se: *“Së pari, fletëthirrja e datës 10.03.2010, në emër të kërkuesit K. B., nuk plotëson ekstremet e një dokumenti, për njoftimin e subjekteve në një procedim penal sipas ligjit. Jo vetëm mungon nënshkrimi i shtetasit të thirrur sipas fletëthirrjes, por shkrimi në këtë akt është i dukshëm ndryshe sa ai që paraqitet në thirrjen e datës 18.10.2010 apo akteve të tjera të nënshkruar nga kërkuesi, të cilat janë të bashkëngjitur në dosje. Së dyti, fakti se shqyrtimi gjyqësor i çështjes në datën 10.03.2010, ka filluar me vonesë, krijojnë dyshime mbi pjesëmarrjen dhe njoftimin e kërkuesit në gjykimin e çështjes. Së treti, në dosjen gjyqësore nuk është administruar vendimi i mosfillimit të procedimit penal, objekt gjykimi, për rrjedhojë vetëm ky fakt është i mjaftueshëm për prishjen e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë dhe kthimin e akteve për rigjykim në këtë gjykatë”*. Ndërkaq, pas verifikimit të materialit kallëzues të datës 21.09.2010, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur më datë 12.11.2010 mosfillimin e procedimit penal mbi bazën e kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2010, për shkak se veprat penale të pretenduara nga kallëzuesi janë shuar dhe, për pasojë, ndjekja penale ndaj tyre nuk mund të vazhdojë. Në këtë vendim, ndër të tjera, parashtrohet se: *“Nga verifikimi i gjithë materialit kallëzues ka rezultuar se është tërësisht i njëjtë me kallëzimet e mëparshme, për të cilat ne jemi shprehur me vendim mosfillimi. Të vetmet materiale të reja të paraqitura prej tij janë vendimi nr. {***}, datë 10.03.2010, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, që ka rrëzuar kërkesën për kundërshtimin e vendimit të mosfillimit nr. {***} të Prokurorisë Lezhë, si dhe vendimi i Gjykatës së Apelit Shkodër që ka vendosur prishjen e vendimit dhe gjykimin e kërkesës së tij me trup tjetër gjykues. Aktualisht është në proces gjykimi kundërshtimi i bërë nga shtetasi K. B., në lidhje me vendimin e mosfillimit nr. {***} të vitit 2009. [...]”*.

24.2.6 Në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 18.10.2010, të Gjykatës së Apelit Shkodër, pas gjyqimit të çështjes nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, kjo e fundit, me vendimin nr. {***}, datë 02.03.2011, ka vendosur pushimin e gjyqimit të çështjes penale në fjalë për shkak të mosparaqitjes së pajustificuar disa herë radhazi të ankuesit. Pas ushtrimit të ankimit ndaj këtij vendimi, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 07.09.2011, ka vendosur sërish prishjen e vendimit nr. {***}, datë 02.03.2011, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në atë gjykatë, duke i caktuar si detyrë që, pasi të sigurohet mbi njoftimin rregullisht të ankuesit, të vijojë me shqyrtimin në themel të pretendimeve të tij. Në

zbatim të këtij vendimi, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimin nr. {***}, datë 16.01.2012, ka vendosur rrëzimin e ankimit të ankuesit K. B. si të pabazuar në ligj dhe lënien në fuqi të vendimit datë 11.01.2010 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për mosfillimin e procedimit penal, argumentuar me faktin e parashkrimit të ndjekjes penale.

24.2.7 Pas ankimit të ushtruar ndaj vendimit të mësipërm, Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. {***}, datë 17.10.2012, ka vendosur sërish prishjen e vendimit nr. {***}, datë 16.01.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, si dhe prishjen e vendimit të mosfillimit të procedimit penal datë 11.01.2010, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, duke urdhëruar vazhdimin e hetimeve. Në këtë vendim, ndër të tjera, arsyetohet se: *“[...] Agron Bushati, me funksion publik të prokurorit, nuk ka kryer veprime që ligji, e pikërisht neni 287 i Kodit të Procedurës Penale e detyron ti kryejë, siç është ai i shënimit në regjistër i njoftimit të veprës penale të marrë nëpërmjet kallëzimit të mbërritur me shkresën nr. {***} prot., datë 24.09.2009, të Komisarariatit të Policisë Shkodër, çka qartazi përbën mospërbushje të rregullt të detyrës së tij për “[...] zhvillimin, brenda kompetencave të caktuara, të hetimeve të nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale (pika 1, neni 277 i Kodit të Procedurës Penale), njëri nga të cilët është edhe regjistrimi i njoftimit të veprës penale, të cilën ai nuk e ka kryer. Po ashtu, e hapur është pasoja e dëmtimit të interesave të ligjshme të shtetit të disiplinimit të kryerjes së hetimeve të nevojshme për ushtrimin e ndjekjes penale, si edhe i interesave të ligjshme të qytetarit K. B., si i dëmtuar nga vepra penale e kanosjes Për sa janë të gjitha ekstremitetet e krimit të “Shpërdorimit të detyrës” si moskryerja e veprimeve në kundërshtim me ligjin, si mospërbushje e rregullt e detyrës nga prokurori që ushtron funksion publik dhe që ka sjellë dëmtim të interesave të ligjshme si të shtetit ashtu dhe të të dëmtuarit K. B.”.* Ndaj këtij vendimi ka ushtruar rekurs prokurori i Prokurorisë së Apelit Shkodër, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. {***}, datë 17.12.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër dhe lënien në fuqi të vendimit nr. {***}, datë 16.01.2012, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë.

24.2.8 Gjykata e Lartë, me vendimin nr. {***}, datë 23.04.2014, ka vendosur pushimin e shqyrtimit të çështjes në Gjykatën e Lartë, argumentuar me faktin se përfaqësuesi i organit të akuzës, Prokurorisë së Përgjithshme, në seancë gjyqësore parashtroi se: *“Nga ndjekja e ecurisë së kësaj çështjeje, rezulton se pavarësisht rekursit të ushtruar nga ana e prokurorit të Apelit Shkodër, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhë ka marrë në konsideratë vendimin e Gjykatës së Apelit Shkodër, si vendim i formës së prerë, ka kryer regjistrimin e procedimit penal duke zhvilluar hetimet lidhur me këtë çështje, sipas përcaktimeve të vendimit të Gjykatës së Apelit Shkodër. Për këtë arsye është kërkuar pushimi i gjykimit të çështjes pasi ka rënë shkak i rekursit dhe mungon objekti i hetimit”.*

24.3 Nga aktet e administruara në dosjen profesionale të subjektit të rivlerësimit, rezulton se në përgjigje të ankesës së shtetasit K. B. drejtuar institucionit të Presidentit të Republikës, Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. {***} prot., datë 14.07.2015²¹, ka informuar këtë të fundit dhe ankuesin, mbi ecurinë e trajtimit të kallëzimit penal nga Prokuroria e Lezhës, ku informohet, ndër të tjera, se: *“Bazuar në vendimin nr. {***}, datë 17.10.2012, të Gjykatës së Apelit Shkodër, Prokuroria Lezhë ka vendosur regjistrimin e procedimit penal nr. {***}/2012, për veprën penale*

²¹ Kjo shkresë është pjesë e dosjes së aftësive profesionale.

të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, lidhur me hetimin e fakteve të pretenduara nga ankuesi K. B.. Në datën 08.03.2013, nga ana e Prokurorisë Lezhë është marrë vendim “Për pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***}/2012”, për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale”.

24.4 Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni ka arritur në konkluzionin se nuk paraqiten shkaqe apo rrethana për veprime të njëanshme apo korruptive nga ana e subjektit të rivlerësimit.

24.5 Gjatë shqyrtimit gjyqësor të çështjes në Kolegj, në seancën gjyqësore të datës 05.11.2025, në përgjigje të pyetjes së trupit gjykues, nëse prej tij është marrë dhe nënshkruar marrja e shkresës me nr. {***} prot., e Komisarariatit të Policisë Shkodër, që ka të bëjë me kallëzimin e shtetasit K. B., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shkresa e cituar nuk është marrë dhe nuk është nënshkruar prej tij.

25. Në vlerësim të shkakut të ankimit të Komisionerit Publik në lidhje me denoncimin nga z. K. B., trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i akteve të fashikullit të kallëzimit penal nr. {***} të vitit 2010, të përcjella në Komision nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lezhë, si dhe akteve të përcjella nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, konstaton se në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër janë regjistruar disa materiale kallëzuese që i përkasin viteve 2008, 2009 dhe 2010, mbi bazën e kallëzimeve të shtetasit K. B. ndaj prokurorit të kësaj prokurorie, Agron Bushati. Në kallëzimet e këtij shtetasi ngrihen pretendime për humbjen e kallëzimit penal që ai kishte depozituar në gusht të vitit 2002 në Komisarariatit të Policisë Shkodër ndaj inspektorit të Bashkisë Shkodër [z. A. P.] për veprën penale të kanosjes, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal. Sipas denoncuesit, kallëzimi penal i kryer prej tij ishte marrë në dorëzim nga subjekti i rivlerësimit, i cili nuk kishte kryer asnjë veprim procedural, pavarësisht interesimit të vazhdueshëm të denoncuesit kallëzues nga viti 2002, deri në vitin 2008, kur ky individ depozitoi edhe një kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues evidenton se ka pasur një sërë vendimmarrjesh të organit të prokurorisë për mosfillimin e procedimit penal apo pushimin e procedimit penal pas regjistrimit të tij [bazuar në urdhërimet disa herë të Gjykatës së Apelit Shkodër], argumentuar me faktin e parashkrimit të ndjekjes penale²², sipas nenit 66 të Kodit Penal. Pavarësisht këtyre vendimeve, në përmbajtjen e tyre referohet se ka rezultuar i vërtetuar fakti se kallëzimi penal i z. K. B. është përcjellë në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër nga Komisarati i Policisë Shkodër me shkresën nr. {***}, datë 13.08.2002, dhe është marrë kundrejt nënshkrimit për verifikim²³, nga prokurori i kësaj prokurorie, subjekti i rivlerësimit Agron Bushati. Nga aktet rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka regjistruar kallëzimin e z. B. në regjistrat e prokurorisë.
26. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se, po ashtu, në aktet e fashikullit nuk gjendet i dokumentuar ndonjë veprim procedural i ndërmarrë nga subjekti i rivlerësimit, për të kundërshtuar faktin e

²² Me vendimin e datës 23.12.2008, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka vendosur mosfillimin e procedimit për kallëzimin penal nr. {***} të vitit 2008 të shtetasit K. B. argumentuar me faktin e parashkrimit të ndjekjes penale; me vendimin e datës 11.01.2010, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë ka vendosur mosfillimin e procedimit penal lidhur me kallëzimin penal nr. {***} të vitit 2009 të shtetasit K. B., për shkak të parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 313/a i Kodit Penal; me vendimin e datës 08.03.2013, kjo prokurori ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. {***} të vitit 2012 (regjistruar në zbatim të vendimit nr. {***}, datë 17.10.2012 të Gjykatës së Apelit Shkodër) argumentuar me faktin e parashkrimit të ndjekjes penale për veprën penale të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal.

²³ Vendim i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër i datës 23.12.2008 për mosfillimin e procedimit penal.

marrjes dhe nënshkrimit për verifikim në faqen e regjistrit, megjithëse për të ka pasur hetime dhe ndjekje penale nga Prokuroritë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe Lezhë, për një periudhë rreth 6 [gjashhtë] vjeçare, të cilat duket se mund të sillnin pasoja serioze profesionale apo personale për vetë subjektin e rivlerësimit. Kur është pyetur në datën 22.12.2008, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, në lidhje me kallëzimin e z. K. B. ndaj shtetasit A. P., duke iu bërë me dije fakti se ky kallëzim ishte marrë në dorëzim prej tij më datë 13.08.2002, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se nuk ishte në gjendje të kujtonte rrethanat e paraqitjes së kallëzuesit në organin e prokurorisë, objektin e kallëzimit penal dhe personat të cilëve iu adresohet kallëzimi. Nga ana tjetër, asnjëherë në gjithë rrugëtimin e këtij procedimi penal, sikurse edhe atë të kryer në ngarkim të tij nga kallëzuesi, z. B., subjekti nuk rezulton të ketë kontestuar që nënshkrimi në regjistër të jetë i tij. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë as gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj se nuk kishte nënshkruar në regjistër për marrjen në dorëzim të kallëzimit penal të denoncuesit kallëzues, sikurse as që nënshkrimi në regjistër që përmban emrin, mbiemrin dhe nënshkrimin e tij, nuk i përkiste atij. Përkundrazi, subjekti mohoi të ketë marrë në dorëzim këtë kallëzim penal, sikurse edhe të ketë nënshkruar në regjistër emrin e tij, pavarësisht se ky pohim nuk gjen pasqyrim në rrethanat e faktit. Ky qëndrim i subjektit të rivlerësimit u mbajt në konsideratë nga trupi gjykues në drejtim të mungesës së bashkëpunimit të tij gjatë procesit, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

27. Pavarësisht se *kallëzimi penal i z. B.*, në ngarkim të ish-punonjësit të IKMT-së [z. A. P.], i përket vitit 2002, mosveprimi i subjektit të rivlerësimit për regjistrimin në regjistrin e njoftimit të veprës penale provohet se ka vazhduar deri në vitin 2008, kur në mungesë të dijenisë mbi ecurinë e kallëzimit penal të depozituar prej tij denoncuesi ndërmori iniciativën për të paraqitur kallëzim penal ndaj subjektit të rivlerësimit, si prokurori që e kishte marrë atë në dorëzim në vitin 2002. Në këto kushte, trupi gjykues i Kolegjit çmoi ta konsiderojë këtë çështje në kuadër të procesit të rivlerësimit të subjektit, duke vlerësuar se mosveprimi i tij, në rastin në fjalë, është në kundërshtim të hapur me detyrimin e parashikuar nga neni 287²⁴ i Kodit të Procedurës Penale, për shënimin në regjistrin e njoftimit të veprës penale të kallëzimit të z. K. B. dhe me detyrimin e parashikuar nga neni 277 i këtij Kodi mbi ushtrimin e ndjekjes penale. Me mosveprimin e tij, subjekti ka cenuar rëndë, jo vetëm interesat e ligjshme të kallëzuesit si palë e dëmtuar nga vepra penale, por edhe interesat e ligjshme të shtetit, duke krijuar perceptimin në publik se ndjekja penale nuk ushtrohet nga organet e sistemit të drejtësisë dhe shkelësit e provuar të ligjit, në rastin konkret, funksionarë publikë, nuk hetohen e ndëshkohen pavarësisht nga përpjekjet e kryera nga një qytetar në mënyrë konsistente e për një hark kohor mbi 10-vjeçar. Në këtë mënyrë, e parë nën dritën e këtyre rrethanave, subjekti i rivlerësimit vlerësohet të ketë diskredituar rëndë pozitën e figurën e prokurorit si mbrojtës i interesit publik dhe perceptimit për sistemin e drejtësisë në përgjithësi.

Në lidhje me denoncimin me postë elektronike të datës 26.09.2023

28. Komisioni, në vendim, në përfundim të shqyrtimit të këtij denoncimi, ka konkluduar se²⁵: *Realizimi i videos nga ana e subjektit në një ambient të mbyllur, në prani të familjarëve të tij,*

²⁴ Në këtë nen përcaktohet: “1. Prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale që i vjen ose që ka marrë me iniciativën e vet dhe në të njëjtën kohë ose nga momenti në të cilin rezulton, emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale”.

²⁵ Shih paragrafët 91.5 - 91.8 të vendimit të Komisionit.

pavarësisht se është një veprim që nuk përputhet me sjelljen e magjistratit, në kushtet kur nuk rezultuan problematika të tjera serioze në të tria kriteret, është e pamjaftueshme për Komisionin për të aplikuar nenin 61/5 të ligjit nr. 84/2016. Komisioni ka vlerësuar se sjellja e subjektit dhe mungesa e kujdesit të treguar prej tij nuk duhet të mbetet pa u trajtuar. Ligji nr. 84/2016 nuk ka të parashikuar dispozita ligjore në lidhje me shkelje të tilla të kryera nga ana e subjektit, pasi me ligj janë kompetencë e një institucioni tjetër. Për këtë arsye, konstatimet e Komisionit në lidhje me sjelljen e subjektit të rivlerësimit jashtë ushtrimit të funksionit, të parashikuara në nenin 103 e vijues të ligjit nr. 96/2016, do t'i përcillen për kompetencë ILD-së për vlerësime të mëtejshme, për të gjykuar nëse ka shkaqe për hetim disiplinor nga ana e këtij organi lidhur me subjektin e rivlerësimit, z. Agron Bushati.

29. Komisioneri Publik, në ankim, ka kundërshtuar arsyetimin e Komisionit, duke pretenduar se: [...] veprimi i kryer nga subjekti i rivlerësimit, vjen në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullave të sjelljes së magjistratit, parashikuar nga neni 4, pika 1 e ligjit nr. 96/2016, i cili përcakton se: “Magjistrati merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtaritë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare”. Referuar jurisprudencës së Kolegjit [...] ngjarja ka ndodhur në vitin 2017, siç konfirmon Komisioni, dhe kanë kaluar pesë vite, duke e bërë të paverifikueshme nga ILD-ja, në zbatim të nenit 117, pika 1 e ligjit nr. 96/2016. Pra, kjo shkelje efektivisht nuk është objekt kontrolli nga organet e tjera, arsye për të cilën i paraqitet juridiksionit kontrollues të Kolegjit. Në përmbledhje të sa më sipër, Komisioneri Publik vëren se sjellja e subjektit të rivlerësimit bie ndesh me mënyrën e sjelljes që pritet nga një prokuror, i cili duhet të kujdeset që veprimet e tij të jenë në përputhje me detyrimet e marra përsipër, duke e vendosur subjektin në situatën e kualifikuar nga neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si cenim i besimit të publikut te sistemi i drejtësisë.
30. Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme, gjatë gjykimit në Kolegj, konfirmoi në parashtrime qëndrimin e Komisionerit Publik në ankim dhe, në fazën procedurale të bisedimeve përfundimtare, vlerësoi se pas debatit gjyqësor në Kolegj pretendimi i subjektit të rivlerësimit për të vlerësuar videon si brenda kufijve të intimitetit familjar nuk i përgjigjet rrethanave faktike të dala nga hetimi administrativ në Komision dhe gjatë debatit gjyqësor në Kolegj, pasi videoja ka prodhuar efekte, për sa kohë, sikurse shprehet subjekti i rivlerësimit në parashtrime, ajo është ndarë privatisht mes kolegësh. Sipas Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, pavarësisht rrethanave të realizimit të kësaj videoje, duhet të mbahet në konsideratë edhe fakti që sendet e përdorura kanë qenë prova materiale, të cilat kanë një regjim të posaçëm për ruajtjen, administrimin dhe lëvizjen e tyre dhe janë marrë nga vendi i ruajtjes së tyre në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër. Kjo sjellje e subjektit të rivlerësimit, në vlerësimin e Drejtuesit të Prokurorisë së Posaçme, është e një shkalle të tillë që cenon si sjelljen jashtëgjyqësore të magjistratit, edhe atë që lidhet me respektimin e normave që kanë për objekt sendet e ruajtura në sekretarinë (dhomën e provave) të organit procedues, pavarësisht statusit të tyre si pjesë e një procedimi penal në hetim, gjykim apo të përfunduar. Në përfundim, Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme është i mendimit se kjo sjellje e subjektit të rivlerësimit nuk duhet vlerësuar vetëm si shkelje jashtëgjyqësore, por duhet vlerësuar edhe si sjellje në ushtrimin e funksionit, pasi subjekti i rivlerësimit nuk duhet të nxirrte prova materiale jashtë vendit të ruajtjes së tyre, pavarësisht motivimit dhe qëllimit me të cilin subjekti i rivlerësimit justifikon këtë veprim.

31. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, ka kundërshtuar shkakun e ankimit, duke pretenduar se episodi i referuar nuk përmbush elementet materiale dhe funksionale për t'u cilësuar si cenim i besimit të publikut, sa kohë është një fragment privat, i izoluar nga praktika e përditshme institucionale dhe nuk shoqërohet nga pasoja konkrete në dëm të qytetarëve ose të sistemit të drejtësisë. Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar në mënyrë të përmbledhur sa vijon.

31.1 Referuar jurisprudencës së Kolegjit, ngjarja ka ndodhur në vitin 2017 dhe kanë kaluar 5 vite, duke e bërë atë të paverifikueshme nga ILD-ja, në zbatim të nenit 117, pika 1 e ligjit nr. 96/2016 dhe, si e tillë, kjo shkelje efektivisht nuk është objekt kontrolli nga organet e tjera, arsye për të cilën i paraqitet juridiksionit kontrollues të Kolegjit.

31.2 Denoncimi i paraqitur është haptazi i pabazuar dhe i instrumentalizuar, pasi nuk ekziston asnjë person i kërcënuar. Videoja është prodhuar në rreth familjar, brenda automjetit të subjektit, e regjistruar nga bashkëshortja dhe e adresuar vetëm ndaj kontekstit “teator” ndaj vajzës së mitur, dhe se ajo nuk është shpërndarë publikisht dhe nuk ka pasur qëllim apo efekt intimidues ndaj të tretëve. Vetë koha e paraqitjes, një ditë para seancës dëgjimore, tregon, sipas subjektit, synim për zënien në befasi të tij me një material intim, ndërkohë që ngjarja daton në vitin 2017, dhe po të kishte ekzistuar realisht një i dëmtuar, do të ishte depozituar denoncim pranë organeve kompetente në atë periudhë.

31.3 Videoja nuk është publikuar apo bërë e aksesueshme për publikun, por është ndarë privatisht mes pak kolegësh dhe pas shumë vitesh është paraqitur një ditë para seancës dëgjimore, në mënyrë që, e shpëputur nga konteksti faktik i punës mbi inventarizimin, të krijojë perceptim të pasaktë mbi sjelljen funksionale të subjektit,

31.4 Një fragment video kaq personal, i realizuar në sferën familjare, nuk mund të shërbejë si bazë racionale për të pretenduar se është cenuar interesi publik nga subjekti i rivlerësimit, i cili në periudhën përkatëse ka kryer punë të gjerë dhe thelbësore në interes të shtetit, inventarizimin, sistemimin dhe përgatitjen për asgjësim të një morie provash materiale që i përkisnin çështjeve penale të gjykuara dhe arkivuara, të destinuara për asgjësim sipas dispozitave përkatëse.

31.5 Objektet që shfaqen në video nuk kanë qenë pjesë e një procedimi penal aktiv (në hetim apo në gjykim), ndërsa integriteti i subjektit dëshmohet edhe nga sjellja e tij e hapur dhe e saktë gjatë seancës para Komisionit, ku ka shpjeguar me detaje rrethanat e episodit. Për më tepër, përtej deklarimeve të tij, nuk rezulton e provueshme as natyra e sendeve si “armë të ftohta” e as se ato janë marrë nga dhoma e provave në mënyrë të tillë që të krijojë implikime disiplinore apo etike.

31.6 Mungon lidhja funksionale me ushtrimin e detyrës në kuptimin e cenimit të procesit penal: objektet e dukshme lidhen me prova materiale të çështjeve të gjykuara e të arkivuara, të destinuara për asgjësim; nuk ka ndërhyrje në prova të çështjeve aktive, e as komprometim të zinxhirit të ruajtjes dhe as pengim të zbatimit të vendimeve. Përkundrazi, periudha përkatëse përkon me ndërhyrje institucionale për të adresuar kaosin shumëvjeçar të administrimit të provave, të normuar me urdhër drejtuesi dhe të pasqyruar në analizën vjetore: inventarizim, grupim sipas viteve, rakordim fizik juridik dhe zhblllokim i urdhrave të ekzekutimit. Kjo veprimtari i shërbeu drejtpërdrejt interesit publik, duke rritur gjurmueshmërinë dhe sigurinë dokumentare.

31.7 Përtej kontestit juridik, sipas subjektit, pasojat njerëzore kanë qenë të rënda, pasi ekspedimi i një materiali intim në një organ zyrtar, ndjekur nga qarkullimi mediatik dhe raportimet, ka tronditur thellë mjedisin e tij familjar, duke bërë që dy vajzat e mitura, sportiste të afirmuara në taekwondo, të braktisin disiplinën për shkak të trysnisë emocionale që u shkaktoi ky denoncim i rremë i devijuar, duke lënë gjurmë të pashlyeshme në zhvillimin e tyre personal e sportiv.

32. Subjekti i rivlerësimit, gjatë gjykimit në Kolegj, në mbështetje të pretendimeve të tij për kundërshtimin e shkakut të ankimit ka paraqitur²⁶: -- vendimin nr. {***} prot., datë 29.07.2024, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka disponuar për arkivimin pas shqyrtimit të çështjes së transferuar nga Komisioni, konkretisht të denoncimit të administruar pranë tij në datën 26.09.2023, pasi ngjarja me të cilën lidhet ky denoncim është përcjellë pranë ILD-së jashtë afatit 5-vjeçar të parashkrimit, më datë 27.10.2023, duke mosplotësuar kriterin e pranueshmërisë të parashikuar nga neni 120, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; -- akte të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, që i përkasin vitit 2018-2019, lidhur me krijimin e grupit të punës për inventarizimin e provave materiale në këtë prokurori, kryetar i të cilit është caktuar subjekti i rivlerësimit, ecurinë e këtij procesi të raportuar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe raportimi i kësaj prokurorie mbi gjendjen e kriminalitetit për vitin 2018; -- fotografi që lidhen me aktivitete të sportit të Taekwondo-së.
33. Në vlerësim të shkakut të ankimit, trupi gjykues çmon të theksojë fillimisht se pavarësisht konkluzionit të mësipërm të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, procesi i rivlerësimit, i parashikuar në Kushtetutë dhe në ligjin nr. 84/2016, është nën kompetencën e posaçme të organeve të rivlerësimit, Komisionit dhe Kolegjit, të cilët kanë të drejtën dhe detyrimin të hetojnë dhe kontrollojnë në mënyrë të pavarur pasurinë, figurën dhe profesionalizmin e subjektit të rivlerësimit, si dhe çdo denoncim të paraqitur nga publiku lidhur me aspekte të vlerësimit të subjekteve. Për këtë arsye, denoncimi i adresuar në Komision, përmes postës elektronike në datën 26.09.2023, iu nënshtrua shqyrtimit gjyqësor në Kolegj.
34. Nga analizimi i akteve të fashikullit të Komisionit në lidhje me këtë denoncim, trupi gjykues konstaton se:

34.1 Në denoncimin e adresuar në Komision, në datën 26.09.2023, nga dërguesja A. D., ngrihen pretendime se prokurori Agron Bushati, nën kërcënimin e armëve të ftohta, kanos një qytetar në mes të qytetit. Sipas denoncimit, ky prokuror ka humbur besimin e opinionit publik, pasi ka vite që në kërcënimin e armëve kanos personat që janë palë në proceset gjyqësore që ai heton apo ka hetuar dhe se duhet të ishte në gjykim për veprat penale të parashikuara nga nenet 88 dhe 278 të Kodit Penal. Me denoncimin përcillet një material *audio video*, nga aksesimi i të cilit evidentohet një person (që pretendohet të jetë subjekti rivlerësimit) i ulur brenda një automjeti, i cili, duke mbajtur një thikë në dorë dhe një dorezë metalike, i drejtohet personit që filmon, me fjalët “*ti ore trim, hajde njëherë këtu hajde*”, ndërkohë që në sfond dëgjohet e qeshura e një fëmije.

34.2 Denoncimi i mësipërm, i paraqitur një ditë përpara seancës dëgjimore, iu përcoll nga Komisioni subjektit të rivlerësimit, i cili, në seancën dëgjimore të datës 27.09.2023, deklaroi se:

²⁶ Aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit janë cituar në poshtëshënimin nr. 6 të këtij vendimi.

*“Më besoni, shokun që pësova nga video që pashë, mënyrën sesi u servir, duket lufta brenda llojit qenka më e ashpër se jashtë llojit. Unë nuk kam as facebook as instagram, nuk i përdor, është mënyrë sesi kam zgjedhur të jetoj [...]. Video bën fjalë për vitin 2017-2018, është intimitet i familjes sime, për shkak të profesionit, në qoftë se ju do të tregoheshit të vëmendshëm ka një qeshje të një fëmije, fëmija që qesh është vajza ime A. B., është nënkampione e Shqipërisë në taekwondo, ekipin {***} [...] Vajza ka qenë në makinë, ishte e mërëzitur atë ditë sepse kishte humb një ndeshje stërvitore dhe thjesht e sugjestionova. Ka qenë periudha kur kam riformatuar zyrën e provave materiale, më falni dhe jam lavdëruar dhe në analizën e vitit 2019 nga prokurori i rrethit, sepse ishte në kolaps zyra e provave materiale në të gjitha prokuroritë e rretheve. [...] mendoj që dhe kush e ka dërguar. Kam dyshimet e mia që bëhet fjalë për të njëjtin subjekt pjesë e administratës së prokurorisë, që ka qenë në konflikt edhe me subjektin e rivlerësimit Sh.M., e cila është kualifikuar pozitivisht e vazhdon detyrën, ku duket se ca e vlerësojnë prokurorinë një familje të dytë, sepse shpenzojmë tetë orë pune, por punojmë dhe pasdite, konsultohemi, jetojmë me hallet e njëri-tjetrit [...], personi që më ka incizuar ka qenë bashkëshortja ime, në sediljen mbrapa ka qenë vajza që e kam marrë nga stërvitja atë ditë sepse nuk jam as me rroba pune jam jashtë orarit zyrtar[...] kjo video është pjesë e intimitetit tim [...]”.*

34.3 Në vijim të seancës dëgjimore, i pyetur nga vëzhguesi ndërkombëtar, mbi arsyet e nxjerrjes së këtyre objekteve jashtë institucionit, pra, nëse veprimi i tij është kryer ose jo në përputhje me rregullat për administrimin e provave materiale nga ana e organit të prokurorisë, si dhe nëse ai ndodhet në kushtet e nenit 279 të Kodit Penal, i cili parashikon veprën penale të mbajtjes pa leje të armëve të ftohta, subjekti ka deklaruar se: *“[...] atëherë kemi qenë në periudhë riformatimi të dhomës së provave materiale. Këto objekte që quhen grusht dërrmues, kemi pasur me dhjetëra, jo vetëm të vendosura në zarfe por dhe të hedhura në të gjithë ambientin e arshivës së provave, kanë qenë dhe veprat penale atëherë të mbajtjes së armëve të ftohta, siç janë grusht dërrmueset ose dorezat e hekurit, ishin në shitje të lirë, në tregun e qytetit Shkodër [...] nga njëra anë ishte vepër penale dhe nga ana tjetër shiteshin rëndom. Atëherë unë i kam pas në makinë, kanë qenë pjesë e provave materiale të pidentifikuara, është kryer ajo video intime me familjen time, dhe janë rikthyer prapë tek zyra e provave [...] doja të bëja një shaka me fëmijën tim, sepse kishte parasysh personazhin N. T. dhe unë meqenëse merret me arte marziale i thashë edhe ti duhet të sillesh si tek filmi. [...] isha afër ndërtesës së prokurorisë sepse po në distancë të afërt është edhe palestra ku stërvitet ime bijë. [...] Unë jam zhvesh nga posedimi sepse i kam vendos të dy objektet prapë në prokurori”. Në lidhje me rrethanat e ngjarjes, subjekti ka shpjeguar se: *“[...] më telefonon trajneri dhe më thotë që ime bijë nuk është mirë emocionalisht, pasi ka humb ndeshjen stërvitore. Kam parasysh këtu që ime bijë ka natyrë pak të ndryshme nga fëmijët e tjerë, është shumë egoiste kërkuese, por edhe e përjeton negativisht. [...] Kjo ka qenë arsyeja sepse e kam çuar në stërvitje për një orë e gjysmë, jam kthyer në organin e prokurorisë, për të përfutur një orë e gjysmë ajo në stërvitje dhe një orë e gjysmë unë në prokurori dhe pasi marr këtë mesazh, vendos t'i marr dy objektet t'i jap një mesazh, sipas filmit vizatimor për fëmijët dhe jam rikthyer po me time bijë e tim e shoqe më pas në organin e prokurorisë, jam ngjitur lart i kam vendos në vend dhe jam larguar. [...] Aktualisht sot në qoftë se ka nevojë për një provë materiale, bëhet kërkesë tek drejtuesi i prokurorisë i cili ja përcjell arshivës, është arkivistja që e gjen dhe ja dorëzon prokurorit të çështjes ose OPGj-së që e ka kërkuar. Në periudhën që bëhet fjalë që lidhet me videon shanset ishin që as 20% që një arkiviste një kryesekretare të arrinte të gjente provën materiale, përjashto**

atyre që mund të ishin në rregull. Pasi u konstatua kjo problematikë, prandaj dhe mu caktua mua dhe e arrita me sukses. Dhe në analizë me Prokurorin e Përgjithshëm është cilësuar si punë e mirë e prokurorisë, sepse ishte problematikë në të gjitha prokuroritë e Republikës. [...] ishte një situatë jo normale kur e kam kryer unë atë veprim”.

34.4 I pyetur, më tej, nga relatorja e çështjes, se cili do të kishte qenë reagimi i tij profesional, nëse si kalimtar në funksionin e prokurorit do të shihte skenën, që një baba në makinë, me këto dy objekte, po i demonstroi vajzës së tij forcën e breshkave Ninxha, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se: *“[...] është e kuptueshme se çfarë qëndrimi do të kisha, por ka lidhje dhe me subjektin, subjekti mund të ishte një oficer policie. [...] unë nuk mund ta mbuloj malin, por ka lidhje edhe me standardin e subjektit, në qoftë se është një punonjës policie, që ekspozon ndoshta dhe armën e tij personale prapë kjo nuk është mirë, por që në rutinën e përditshme, arma e tij personale është një objekt që ekspozohet në shtëpi, lihet në një vend të caktuar, zhvishet uniforma, po kështu vishet uniforma etj., etj., unë nuk kam ekspozua armë, në një kohë që kisha armë por ekspozova këto të dyja sepse ninxhat nuk kishin armë zjarri kishin armë të ftohta”.*

- 35.** Në vlerësim të shkakut të ankimit, në lidhje me denoncimin e dërguar përmes postës elektronike në Komision në datën 26.09.2023, trupi gjykues i Kolegjit pranoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit për kohën dhe rrethanat e realizimit të video regjistrimit, ndonëse ai nuk paraqiti prova për të mbështetur versionin e tij të ngjarjes, përkundrazi ra në kundërtënie, pasi teksa pretendoi në një rënë anë se ngjarja kishte ndodhur në vitin 2017, njëkohësisht deklaroi se kjo periudhë përkonte me procesin e inventarizimit të provave materiale të organit të prokurorisë, proces që referuar akteve të pranuar në cilësinë e provës në Kolegj, rezultoi i iniciuar me urdhrin e Drejtuesit të Prokurorisë Shkodër, në muajin dhjetor të vitit 2018. Pavarësisht nga kjo qasje, kundërshtitë në shpjegimet/pretendimet e subjektit të rivlerësimit dëshmojnë për një sjellje të vazhdueshme të tij në raport me të vërtetën, evidentuar edhe më lart në lidhje me mospranimin e marrjes dhe nënshkrimit në regjistër nga ana e tij të kallëzimit të shtetasit K. B.. Edhe në versionin që kjo video nuk është regjistruar në vitin 2017, por në periudhën 2018 – 2019, kur është kryer procesi i inventarizimit të provave materiale në organin e prokurorisë, veprimet e subjektit, për përdorimin e tyre në kundërshtim me dispozitat procedurale penale, tregojnë për mungesë përgjegjshmërie të theksuar në përmbushjen e detyrës. Trupi gjykues vlerëson se përdorimi i një sendi që ka qenë provë materiale, i marrë nga vendi i ruajtjes në Prokurorinë ku ushtronte detyrën subjekti, është një veprim në kundërshtim të hapur me rregullat për marrjen, ruajtjen dhe disponimin e tyre të parashikuara nga nenet 187 – 190 të Kodit të Procedurës Penale dhe rregullat e brendshme mbi organizimin dhe funksionimin e organit të prokurorisë. Përdorimi i provave materiale në kushte paligjshmërie të hapur në këtë rast nga një prokuror që njeh rëndësinë e tyre, për më tepër i një “arme të ftohtë”, përveçse mund të ketë pasoja të dëmshme për shëndetin e jetën e personave të pranishëm, mund të cenojë e rrezikojë edhe gjithë procesin penal, për të cilin ato janë administruar, duke sjellë si pasojë edhe dëmtimin e interesave të individëve apo të shtetit në dhënien drejtësi. Trupi gjykues e konsideroi këtë veprim të subjektit si një shkelje shumë të rëndë të ligjit, që bie ndesh me sjelljen etike që pritet nga një prokuror gjatë ushtrimit të funksionit ose jashtë tij, në drejtim të zbatimit të dispozitave ligjore që rregullojnë mënyrën e organizimit dhe funksionimit të organit të prokurorisë.

36. Në rrethanat konkrete faktike e ligjore të evidentuara në rastet e ardhura në analizë përmes denoncimeve²⁷, veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit, në drejtim të moszbatimit të dispozitave procedurale penale gjatë ushtrimit të detyrës, u konsideruan shkelje, sipas përcaktimeve të neneve 74, pika 1 dhe 75, pikat 1 e 2 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të cilat e tejkalojnë aspektin e mungesës së njohurive ligjore e aftësisë profesionale e që mund të korrigjohen përmes programit të trajnimit pranë Shkollës së Magjistraturës. Përkundrazi, trupi gjykues vlerëson se ato tregojnë një qasje e sjellje vazhduese e jo të përshtatshme të subjektit të rivlerësimit që fillon prej vitit 2002 e në vijim përgjatë karrierës së tij shumëvjeçare, e cila nuk është rikuperuar me gjithë kohën e mjaftueshme që subjekti i rivlerësimit ka pasur për reflektim e korrigjim, edhe pasi është njohur dhe i është nënshtruar edhe dy masave disiplinore nga dy Prokurorë të Përgjithshëm, përkatësisht në vitin 2005²⁸ dhe në vitin 2008, cituar më lart.
37. *Së fundmi*, natyrën vazhduese të sjelljes së dëshmuar nga subjekti, në mungesë të rëndë përgjegjshmërie për zbatimin e dispozitave procedurale e materiale penale, sikurse edhe atyre që kanë për qëllim organizimin e funksionimin e prokurorisë, e dëshmon qartë edhe fakti që rezulton nga burime të hapura²⁹ për caktimin e masës disiplinore për të edhe gjatë procesit të rivlerësimit, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, në datën 29.10.2024, për t’i dhënë “Vërejtje publike” subjektit të rivlerësimit, për shkak të shkeljes së të drejtave të një individi, duke mos nxjerrë për një kohë shumë të gjatë urdhrin për ekzekutimin e një vendim penal të formës së prerë³⁰.
38. Trupi gjykues krijoi bindjen se problematikat në aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit të evidentuara më lart, shtuar këtyre qëndrimin jobashkëpunues të subjektit të rivlerësimit, në Kolegj, në rastin që i përket denoncuesit K. B. dhe kundërthëniet e tij mbi zhvillimin e ngjarjes (evidentuar në paragrafin 35 më lart) në rastin e denoncimit të përcjellë përmes postës elektronike, nuk kanë mbetur në të kaluarën, por ato u gjetën të pranishme deri sot e kësaj dite dhe nuk ndryshuan pavarësisht sanksioneve disiplinore të mëparshme. Në këtë situatë, në vlerësimin e trupit gjykues, një sanksion disiplinor më i butë nuk do të ishte efektiv e as proporcional.
39. Në konkluzion të analizës së mësipërme, duke mbajtur në konsideratë se cenimi i besimit të publikut nuk vlerësohet bazuar në kritere sasiore/numerike, por me rëndësinë dhe peshën që kanë problematikat e evidentuara në çështjet e trajtuara nga subjektet e rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit çmon se në një vlerësim tërësor, problematikat e evidentuara më lart, të kthyer në një mënyrë sjelljeje në vazhdimësi, në mungesë të theksuar përgjegjshmërie, në ushtrimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, në sytë e një vëzhguesi të arsyeshëm, përbëjnë mjaftueshëm një bazë të dhënash mbi të cilën konkludohet se subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë.

²⁷ Denoncimet e K. B. dhe A. D.

²⁸ Me urdhrin nr. {***}, datë 30.11.2005, të Prokurorit të Përgjithshëm, subjektit të rivlerësimit i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje me paralajmërim për largim nga detyra”.

²⁹ Vendimi nr. {***}, është aksesuar nga faqja zyrtare e Këshillit të Lartë të Prokurorisë: https://klp.al/wwwp-content/uploads/2024/11/v.nr.{***}-i-anonimizuar.pdf.

³⁰ Ky fakt nuk i është nënshtruar vlerësimit në kuadër të shqyrtimit të kësaj çështjeje nga trupi gjykues, por është referuar vetëm për të evidentuar se shkeljet e kryera nga subjekti në kundërshtim të hapur me legjislacionin në fuqi, në cenim të të drejtave të subjekteve procedurale të hetimit/ndjekjes penale e vuajtjes së dënimit penal, e jo vetëm, janë një sjellje e përsëritur e tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Ky konkluzion e bën të zbatueshëm në mënyrë autonome nenin 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, si një prej shkaqeve të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

40. Sa më sipër, në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të çështjes, trupi gjykues i Kolegjit çmon se vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 702, datë 27.09.2023, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Agron Bushati, nuk është i bazuar në prova dhe në ligj dhe, si i tillë, duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit me nr. 702, datë 27.09.2023 dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Agron Bushati.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall në Tiranë, sot më datë 25.11.2025.

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

KRYESUESE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi